



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primijeno/Prodato Received/Delivered	18 - 08	2022	2	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jedinstvo Org./Unit	SIKOMSTAK	4802/2022	14	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.553/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetar, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani -anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.553/2022 të datës 21.06.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë:

kundër organit të punësimit/Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale,, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 18.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa më numër A.nr.553/2022 e datës 21.06.2022 parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale sipas Akt Emërimit të datës 14.03.2012 në pozitën: "Kryesues i Sektorit të Arkivit", në Departamentin e Gjeologjisë/ Divizionin e Arkivit, me koeficientin tetë (8), me datë 18.05.2022 ka parashtruar kërkesë me numër protokoll 4540 tek Drejtori i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për jetësimin e koeficientit nëntë (9) sipas Vendimit nr. Protokoll 3613 të datës 06.10.2021, dhe Vlerësimit të komisionit për shqyrtimin e kërkesave të stafit me numër protokoll 2628 të datës 08.04.2019, për ngritjen e koeficientit, ngritjen e pagave apo ndërrim të pozitive.

Ankuesi pasi që nuk ka pranuar përgjigje lidhur me kërkesën e datës 18.05.2022, ka parashtruar ankesë me datë 21.06.2022 në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, për mos zbatimin e Vendimit me numër protokoll 3613 të datës 06.10.2021 të Drejtorit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, me pretendimin ankimore që ti bëhet harmonizimi i koeficientit



nga koeficienti nëntë (9) i cili vendim është bazuar në e-milin e datës 12.07.2011 të Drejtorit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për kalimin e Zyrës së Regjistrimit në Sektorin e Arkivit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.06.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, e cila me datë 07.07.2022 ka dërguar përgjigjen në ankesë, së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës prej 1/13 faqe.

Me datë 03.08.2022 Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me VK.nr.77/2022 për vazhdimin e afatit të ankesës me numër Anr.553/2022 të datë 21.06.2022, lidhur me kërkesën e datës 03.08.2022 të Kryetares së Kolegjit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të natyrës së lëndës specifike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:3597/2022 të datës 21.06.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Letër emërimi i datës 15.05.2009; Akt Emërimit të datës 14.03.2012; E-mail i datës 12.07.2011; Procesverbal i mbledhjes së departamentit të Gjeologjisë i datës 15.05.2012; E-mail i datës 29.11.2012; E-mail i datës 10.07.2013; mostër vendim ; E-mail i datë 28.06.2013; E-mail i datës 27.06.2013; -mail i datës 11.11.2019; Njoftim i datë 0.11.2013; Kërkesë e datës 26.03.2015; Procesverbal i mbledhjes së departamentit të Gjeologjisë i datës 12.01.2016; Kërkesë për avancim në punë e datës 15.06.2017; Shqyrtimi i kërkesës së stafit KPMM i datës 03.04.2019 nr. Protokolli 2500; Forma tabela -lista e kërkesave e datës 25.03.2019 prej 1/3 faqe; Vendimi nr. Protokolli 3613/2021 i datës 06.10.2021; E-mail i datës 06.10.2021; Kërkesë nr.7942 e datës 18.11.2021; shqyrtim i kërkesës se stafit KPMM me nr. 2628 i datës 08.04.2019; Kërkesë nr.74540 e datës 18.05.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 07.07.2022; prove shtesë e-mail i datës 01.08.2022; Përshkrim i punës; lista e pagave prill 2022, maj 2022, qershor 2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me ngritjen e koeficientit nga koeficienti tetë (8), në koeficient nëntë (9), gjegjësisht jetësimin e koeficientit nëntë (9), sipas Vendimit me numër protokolli 3613 të datës 06.10.2021 të Drejtorit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Vlerësimit të komisionit për shqyrtimin e kërkesave të stafit me numër protokolli 2628 të datës 08.04.2019, për ngritjen e koeficientit, ngritjen e pagave apo ndërrim të pozitave dhe ka konstatuar se pretendimet ankimore te ankuesit janë të pa bazuara në ligj, sepse ne baze të dëshmimeve të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit ankuesi është punësuar në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale sipas Akt Emërimit të datës 14.03.2012 në pozitën: "Kryesues i Sektorit të Arkivit", në Departamentin e Gjeologjisë/ Divizionin e Arkivit, me koeficientin tetë (8).

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që ti bëhet koeficientit nëntë (9) , njëkohësisht kërkon që Sektori i Arkivit të kaloj si strukture në Divizion të Arkivës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, konstaton se me dispozitat e nenit 7 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, është përcaktuar se: *"1. Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat"*, rrjedhimisht Kolegji, vlerëson se ankuesi ka themeluar marrëdhënie të punës sipas Akt Emërimit të datës 14.03.2012 me koeficientin tetë (8), andaj paguhet konform koeficientit të përcaktuar me Akt Emërim, ndërsa neni 9 paragrafi 1 i Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ku përcakton se: *"Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës"*. Mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar se Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, nuk mund të bëjë ngritjen e koeficientit me vendim të brendshëm sipas kërkesës së ankuesit pa bazë ligjore, pa planifikim të mjeteve buxhetore të miratuar nga Ministria përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministria e Financave, si dhe pa miratim të Qeverisë për grada për secilin pozitë të punës dhe ndryshimet e tyre, të përcaktuar në dispozitën e cekur si më lartë.

Duke marr parasysh që në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, të gjithë nëpunësit e kategorisë së pozitës që mban ankuesi paguhet me koeficient të njëjtë dhe nuk ka asnjë dallim në koeficient, Kolegji vlerëson që në këtë rast nuk ka trajtim të pabarabartë dhe diskriminues në mes të punësuarve siç parashihet me nenin 4 paragrafi 1 Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi ku thuhet se: *"Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, si rrjedhojë në këtë rast veprohet në pajtim të plotë edhe me nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, kështu që pretendimet e ankuesit sa i përket koeficientit janë të pabazuara.*

Sa i përket pretendimit të ankuesit lidhur me kalimin e Sektorit të Arkivit si strukture organizative në nivel të Divizionit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se çështja e strukturës organizative të institucionit duke përfshirë përcaktimin e niveleve përkatëse drejtuese, të funksioneve dhe të përgjegjësive është e përcaktuar me Ligjin Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura dhe institucionet janë të obliguar që ne pajtim me këtë ligj të hartojnë dhe miratojnë rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe rrjedhimisht derisa në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale nuk është në fuqi rregullorja për organizimin e brendshëm e cila përcakton Divizionin si strukture organizativë, atëherë edhe pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, nenin 18

paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.553/2022

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtor i Përgjithshëm në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.